

[Dt 19.12.2023]

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** • Shërbimet e zhvillimit të softwareve 72262000-9, • Sistemet e informacionit gjeografik (gis ose ekuivalent) 38221000-0, • Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit 72267100-0.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 11.249.666 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh, me objekt: "Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës",** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023" i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. **"Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës",** në programin buxhetor "Investim (231)" me tipologji **"Sistem software"** me vlerë të fondit limit 3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
2. **"Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës",** në programin buxhetor "Shpenzime operative (602)" me tipologji **"mirëmbajtje +trajnim"** me vlerë të fondit limit 7.499.500 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

*Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 20000 (ose ekuivalent) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

#### **Argumentimi 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4:**

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të

*përshtatshëm cilësie... ”*

*si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:*

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

*2.3.2 Kërkesa për ISO 9001 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit e shërbimit sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*2.3.3 Standardi ISO 20000 (ose ekuivalent) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit. Projekti “Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës” kërkon planifikim (sipas termave të referencës “Faza përgatitore për platformën”), zhvillim, përmirësim dhe testim të sistemit, trajnim të stafit si dhe mirëmbajtje përgjatë 24 (njëzet e katër) muajve, konkretisht sipas fazave të përcaktuara në dokumentin e termave të referencës:*

*Faza I – Faza përgatitore për platformën*

*Faza II – Faza e përmirësimit dhe zhvillimeve të reja*

*Faza III – Faza e integritit dhe testimit të platformës*

*Faza IV – Trajnimi i përdoruesve*

*Faza V- Dorëzimi Përfundimtar/ Marrja në dorëzim*

*Faza VI – Mirëmbajtje e platformës*

*Projekti kërkon realizim brenda një periudhe kohore të parapërcaktuar, relativisht të shkurtër dhe shërbime intensive që duhen të jenë detajisht të monitoruara.*

*Përsa më sipër, kërkesa është një domosdoshmëri për suksesin e kontratës.*

*2.3.4 ISO 27001 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe*

*ofron një standard të qartë të politikave dhe procedurave që organizatat duhet të ndjekin për të siguruar të dhënat e tyre dhe për të parandaluar humbje të të dhënave ose shkelje të sigurisë. Certifikimi me standardin ISO 27001, i siguron AK, mbrojtjen e të dhënave, identifikimin e rrisqeve të sigurisë dhe në ndërmarrjen e masave për t'i parandaluar ato. Kjo përfshin hartimin e politikave, procedurave dhe masave teknike që ndihmojnë në parandalimin e shkeljeve të sigurisë dhe incidenteve të mundshme. Rrjedhimisht ISO 27001 (ose ekuivalente) është e nevojshme për AK për sigurinë dhe të dhënat krijon besueshmëri në implementimin e kontratës.*

**2.3.5** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) menaxher projekti, i punësuar pranë operatorit ekonomik i cili duhet të ketë eksperiencë të paktën 1 (një) vit si menaxher projekti dhe duhet të plotësojë të paktën njërin nga kushtet:
  - të zotërojë një nga certifikatat: PMP, Waterfall, Agile, PRiSM, PRINCE 2, Scrum (ose ekuivalente);
  - ose të jetë i diplomuar në Menaxhim Projektsh (ose ekuivalente).
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim software në teknologjinë me të cilën është ndërtuar sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente) për të garantuar zhvillime, përmirësime të software dhe mirëmbajtjen e tij sipas kërkesave të termave të referencës bashkëlidhur. Gjithashtu stafi i kërkuar sipas kësaj pikë (2.3.5/b) duhet të ketë eksperiencë pune, për të paktën një periudhë 1 (një) vjecare, në projekte në fushën e sistemeve informative të bazuara në GIS.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e bazës së të dhënave.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për GIS, me minimumi 1 (një) vit eksperiencë në përpunimin e të dhënave GIS. Personat duhet të ketë marrë pjesë në të paktën 1 (një) projekt të përpunimit të të dhënave hapësinore dhe mbështetjes teknike në lidhje me urbanizmin, kadastrën ose të ngjashme.

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar ose diplomë aty ku kërkohet si alternativë.
- CV
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (cerifikimin, diplomimin dhe vitet e eksperiencës), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
- Listëpagesat sipas formularit e-Sig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër cituar.

Shënim: Kriteri 2.3.5 dhe nënkomponentët e tij pika a ,b, c,d do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Referuar nenit 41 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), citohet:

*..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”*

a) Kërkesa për “*të paktën 1 (një) menaxher projekti, i punësuar pranë operatorit ekonomik i cili duhet të ketë eksperiencë të paktën 1 (një) vit si menaxher projekti dhe duhet të plotësojë të paktën njërin nga kushtet:*

- *të zotërojë një nga certifikatat: PMP, Waterfall, Agile, PRiSM, PRINCE 2, Scrum (ose ekuivalente);*
- *ose të jetë i diplomuar në Menaxhim Projektsh (ose ekuivalente)”.*

Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti, që prej analizës së situatës aktuale dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që të gjithë shërbimet e kërkuara të kryhen me sukses, me cilësi si dhe në afat, sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit dhe referuar standardeve më të mira në fushë. Eksperienca e të paktën 1 (një) vit experience, ndihmon në një kuptim më të thellë të sfidave të projekteve, aftësinë menaxheriale dhe në dhënien e rezultateve më të mira, në funksion të garantimit të suksesit të kontratës.

b). Kërkesa për

*“të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim software në teknologjinë me të cilën është ndërtuar sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente) për të garantuar zhvillime, përmirësime të software dhe mirëmbajtjen e tij sipas kërkesave të termave të referencës bashkëlidhur. Gjithashtu stafi i kërkuar sipas kësaj pikë (2.3.5/b) duhet të ketë eksperiencë pune, për të paktën një periudhë 1 (një) vjecare, në projekte në fushën e sistemeve informative të bazuara në GIS.”*

është një kërkesë e domosdoshme e cila i provon autoritetit se Operatori Ekonomik ka në përbërjen e tij staf të aftë e të kualifikuar në krijimin dhe zhvillimin e sistemeve informatike dhe përmbushjen e detyrave të kërkuara, konkretisht (por nuk kufizohet në) me zërat:

- Zhvillime, përmirësime të sistemit GIS (analizë, zhvillim, testim, dorëzim)

- Mirëmbajtja e sistemit

Çertifikimi mundëson mënyrën më efikase të zhvillimit, duke optimizuar performancën dhe shkallën e përdorimit të resurseve. Angazhimi i një punonjësi me eksperiencë pune, për të paktën një periudhë 1 (një) vjecare, në projekte në fushën e sistemeve informative të bazuara në GIS është i nevojshëm për t'i përballuar sfidat e kompleksitetit të kësaj fushe dhe për të siguruar përmirësimin e sistemit GIS të përshtatshëm dhe cilësor për nevojat specifike të AK. Sistemet Informative Gjeografike janë shumë komplekse dhe ndërthuren me një sërë aspektesh të tjera të teknologjisë së informacionit dhe të hartave gjeografike. Zhvillimi i një sistemi GIS kërkon njohuri të specializuara të programimit, modelimit të të dhënave gjeografike, dhe integrimin e teknologjive të ndryshme. Stafii me me përvojë në këtë fushë është i aftë të përmbushë këto kërkesa të veçanta dhe ofrojë sigurinë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë komponentëve të sistemit:

- Sistemin web based
- Serveri Gis (Geoserver)

c) Kërkesa për “(një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e bazës së të dhënave.”

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për krijimin dhe administrimin e databazës dhe mirëmbajtjen eficiente të saj.

Kjo kërkesë lidhet me një nga detyrat kryesore të kërkuara nëpërmjet kësaj kontrate, për të menaxhuar, siguruar dhe optimizuar të dhënat gjeografike dhe për të siguruar funksionimin efikas dhe të sigurt të sistemit GIS.

d) Kërkesa për “Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për GIS me minimumi 1 (një) vit eksperiencë në përpunimin e të dhënave GIS. Personat duhet të ketë marrë pjesë në të paktën 1 (një) projekt të përpunimit të të dhënave hapësinore dhe mbështetjes teknike në lidhje me urbanizmin, kadastrën ose të ngjashme”.

Një punonjës i kualifikuar i GIS është i rëndësishëm dhe thelbësor për AK, për shkak të njohurive të teknologjisë së informacionit gjeografik, analizës së të dhënave gjeografike dhe volumit të tyre, hartëzimit, përdorimit të software-ve dhe teknologjive të GIS, integrimin e të dhënave gjeografike me aplikacione të tjera, dhe për sigurimin e mbështetjes teknike. Puna e kualifikuar dhe eksperiencia e punonjësit të GIS siguron suksesin dhe efikasitetin e implementimit të kontratës.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.



- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Argumentim i termave të referencës:**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet këtij shërbimi, por nuk kufizohen në janë:

- Përmirësimi i funksionaliteteve;
- Përditësimi / upgrade i teknologjive të përdorura në teknologjitë më të fundit të rekomanduara ;
- Krijimi i proceseve/ ambienteve të reja sipas nevojave;
- Integritet me sisteme të tjera që hostohen në institucion dhe jo vetëm;
- Mirëmbajtje e platformës për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj, ku do të përfshihet mirëmbajtja e saj me të gjithë komponentët përbërës, ekzistues dhe të rinj që do të shtohen, pra dhe e versionit të përditësuar të platformës, për të garantuar disponueshmërinë dhe vazhdimësinë e pandërprerë të punës nëpërmjet saj.

*Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është realizimi i përmirësimeve e zhvillimeve të reja të sistemit GIS të Bashkisë Tiranë, për plotësimin e nevojave/ kërkesave të institucionit, si dhe dhe sigurimi i vazhdimësisë së punës në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem nëpërmjet mirëmbajtjes së tij në çdo komponent përbërës.*

### **Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori**

Operatori Ekonomik fitues duhet të realizojë detyrat sipas kërkesave të përshkruara:

- Zhvillime e përmirësime të sistemit në përputhje me proceset e punës dhe kërkesat e përcaktuara në këto terma reference apo që mund të dalin gjatë fazës së analizës, duke respektuar standardet dhe praktikat më të mira.

- Mirëmbajtja e sistemit të përmirësuar dhe garantimi i disponueshmërisë të këtij sistemi brenda kushteve të kërkuara për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **”Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*

*Termet e referencës*

**NJËSIA E PROKURIMIT**